



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 4062 Prot.

Tiranë, më 20.09.2019

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 8- mujorin e vitit 2019

Drejtuar: **Z. Arjan KRAJA**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 8-mujorin e vitit 2019, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit nr.1, datë 17.1.2019, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019» i ndryshuar, dhe shkresës nr.9078/1 prot., datë 21.5.2019, « Për miratimin e detajimit të fondit të veçantë për vitin 2019» nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i është akorduar fondi buxhetor prej 142 milion e 880 mijë lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 102 milion e 500 mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 700 mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative: 21 milion e 260 mijë lekë (zëri 602)
Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)
Transferime korrente: 420 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin “*Menaxhim, Administrim, Planifikim*” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2019-2021, për realizimin e misionit të ILDKPKI, i cili kërkon një menaxhim efektiv të fondeve buxhetore të akorduara për ILDKPKI, në funksion të përcaktimit të rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë dhe për personat e lidhur me ta, si edhe të garantojë një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të zyrtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre si dhe parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik dhe privat, nëpërmjet mekanizmit të sinjalizimit

Inspektorati i Lartë, për 8–mujorin e vitit 2019, në realizimin e shpenzimeve buxhetore, është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit tërësor të infrastrukturës institucionale, në funksion të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe me zbatimin e politikave buxhetore përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare, për realizimin e objektivave prioritare si;

- Drejtimi dhe përmirësimi i politikave dhe mekanizmave për kontrollin e vërtetësisë dhe saktësisë së pasurive, të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike, si instrumente të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit.
- Forcimi i mëtejshëm i teknikave të hetimit administrativ jo vetëm në identifikimin e pasurive të fshehura apo të padeklaruara, por sidomos në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të rasteve të konfliktit të interesave.
- Hetimi mbi pasuritë dhe burimin e të ardhurave të personave jo zyrtarë që kanë interesa të përbashkëta me subjektin deklarues dhe forcimi i punës për zbulimin e rasteve të fshehjes apo deklarimit të rremë të zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin.
- Parandalimi i rasteve të pasurimit në rrugë abuzive të zyrtarëve dhe të personave të lidhur me ta.
- Parandalimi i rasteve të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.
- Penalizmi i rasteve të abuzimit nga zyrtarët me funksionet e tyre publike.
- Parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit, nga hakmarrja në përputhje me ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Ligjit nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në shumën 88,696,780.93 lekë ose 87.49%, të fondit të planifikuar për 8 mujorin e vitit 2019.

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2019	Plan-Buxheti i ndryshuar 8-mujor 2019	Plan-Buxheti 8-mujor 2019	Buxheti i realizuar 8-mujor 2019	Realizimi në % si 8-mujor
600	Fond Page	102.500,00	102.500,00	70.300,00	69.260,20	98,5%
601	Kontrib.Sig.Shoq & Shend	15.700,00	15.700,00	10.700,00	9.471,90	88,5%
602	Shpenzime operative	21.260,00	21.260,00	17.040,00	8.694,00	51,0%
606	Transferta per financime te tjera	240,00	420,00	340,00	209,30	61,6%
231	Investime	3.000,00	3.000,00	3.000,00	1.061,40	35,4%
Shuma		142.700,00	142.880,00	101.380,00	88.696,80	87,49%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Për 8-mujorin e vitit 2019, numri i punonjësve është realizuar 70 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.16, datë 16.1.2019, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore”, për shkak të nevojave të institucionit, është miratuar një punonjës me kontratë të përkohshme deri në fund të vitit 2019.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën **69,260,194** lekë ose **98.5%** e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **9,471,879** lekë ose **88.5%**, e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

Fondi për shpenzime në zërin investime (zëri 231),

Në totali i planifikuar i investimeve për vitin 2019, është 3 milion lekë, të miratuar si produkte nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt “Pajisje Kompjuterike dhe Elektronike

të Blera për Zyra” me fond limit 1,500,000 lekë me tvsh ose 1,250,000 lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën “Kërkesë me Propozim” dhe është fituar nga firma private “BNT Electronics” sh.p.k në vlerën 1,061,400 lekë me tvsh dhe 884,500 lekë pa tvsh ose 71% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara, ndërsa produkti me objekt “Sistem Audio Prezantimi i Blerë” me fond limit 1,500,000 lekë me tvsh ose 1,250,000 lekë pa tvsh, do të prokurohet në mbështetje të Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602),

Realizimi për grupin e shpenzimeve operative për 8- mujorin 2019 është gjithsej në vlerën 8,693,956.93 lekë me tvsh ose 51% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Për 8-mujorin e vitit 2019, realizimi në grupin e shpenzimeve operative është mbështetur duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Diferencat në vlerë përbëjnë kursime gjatë procesit të prokurimit të cilat janë rishpërndarë sipas nevojave më të domosdoshme të institucionit.

1. Fondi i parashikuar për grup artikullin shërbimi me objekt “*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*”, është prokuruar, në zbatim të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Për nevojat e institucionit për vitin 2019, për shërbimin e ruajtjes me roje civile është realizuar tender me procedurën “*Kërkesë me Propozim*” me Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, kjo procedurë është fituar nga AK “*Trezhnjeva shpk*”, në vlerën 3,160,218.16 (*tremilion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë, pik gjashtëmbëdhjetë*) lekë pa tvsh si oferta e fituese me të cilën është lidhur marrëveshja kuadër me afat -12 muaj, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

2. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Blerje materiale kancelarie*”, me fond limit për 750,000 lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma private “*Infosoft Office*” sh.p.k në vlerën 721,000 lekë pa tvsh ose 96% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.

3. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Shërbim për riparim/mirëmbajtje për 3 automjete të ILDKPKI*”, me fond limit për 416,667 lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma private “*Servis –Auto 2000*” sh.p.k në vlerën 389,600 lekë pa tvsh ose 93.5% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.

4. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Blerje Karburant*”, me fond limit për 750,000 lekë, pa tvsh është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma private “*Kastrati*” sh.p.k në vlerën 696,729.17 lekë pa tvsh ose 92.8% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr.1976 Prot., datë 7.03.2019.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin shpenzime si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu, për periudhën respektive janë realizuar kontrata shpenzim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve etj. të cilat institucioni ynë, i likujdon, në mbështetje të kushteve të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, «*Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë*» i ndryshuar, Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike*” i ndryshuar, Ligji nr.60/2016, datë 2.6.2016 «*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*» nga subjekte në sektorin publik dhe privat.

Për 8-mujorin e vitit 2019, janë gjithsej 20 raste, në vlerën **3,985,000** lekë.

- 2) Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbarimore të rretheve për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë. Për këtë periudhë vjetore janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 26 raste, në vlerën **4,642,000** lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për periudhën janar – gusht 2019, janë në vlerën 8,627,000 lekë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 datë 28.06.2006 “*Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore*”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojë me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

NËPUNËS AUTORIZUES

Evgjeni BASHARI



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Inspektorati I Larte I Deklarimit dhe Kontrollit te pasurive dhe Konfliktit te Interesave					Kodi i Grupit		76
Programet		Shpenzimet e Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti 8-Mujor	Fakti	Diferenca	
Titulli	Emertimi	I Viti 2018	Viti 2019	Plan Fillestar Viti 2019	Plan I Rishikuar Viti 2019	Plani I Periudhes 8mujore/progresiv	i Periudhes- 8 - mujore/progresiv		
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	133.564,22	142.700,0	142.700,0	142.880,0	101.380,0	88.696,7	-12.683,3	
Totali I Shpenzimeve te ILDKPKI		133.564,2	142.700,0	142.700,0	142.880,0	101.380,0	88.696,7	-12.683,3	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit									
Totali		133.564,2	142.700,0	142.700,0	142.880,0	101.380,0	88.696,7	-12.683,3	


Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgjeni Bashari
	Firma	<i>Bashari</i>
	Data	



ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		ILDKPKI					Kodi i Grupit	1076001
Programi							Kodi i Programit	01110
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Plan Viti2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes- 4 muajore/progresiv	(6) Fakti i Periudhes- 4 - muajore/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	101.255,46	102.500,0	102.500,0	102.500,0	70.300,0	69.260,0	-1.040,0
601	Sigurime Shoqërore	13.532,10	15.700,0	15.700,0	15.700,0	10.700,0	9.471,8	-1.228,2
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	15.688,90	21.260,0	21.260,0	21.260,0	17.040,0	8.694,0	-8.346,0
603	Subvencione							0,0
604	Transferta Korente të Brendshme							0,0
605	Transferta Korente të Huaja							0,0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	389,10	240,0	240,0	420,0	340,0	209,4	-130,6
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	130.865,56	139.700,0	139.700,0	139.880,0	98.380,0	87.635,2	-10.744,8
230	Kapitale të Patrupezuara							0,0
231	Kapitale të Trupezuara	2.698,66	3.000,0	3.000,0	3.000,0	3.000,0	1.061,5	-1.938,5
232	Transferta Kapitale							0,0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	2.698,66	3.000,0	3.000,0	3.000,0	3.000,0	1.061,5	-1.938,5
230	Kapitale të Patrupezuara							0,0
231	Kapitale të Trupezuara							0,0
232	Transferta Kapitale							0,0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	Shpenzime Kapitale	2.698,66	3.000,0	3.000,0	3.000,0	3.000,0	1.061,5	-1.938,5
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0,0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		133.564,22	142.700,0	142.700,0	142.880,0	101.380,0	88.696,7	-12.683,3

Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri. Miranda Porja	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgjoni Bashari
	Firma		Firma	
	Data		Data	



ANEKSI nr.3 "Raporti përmbljedhës i realizimit të treguesve të performancës/produktive të programit"

Emri i Grupit	ILDP/PS	Kodi i Grupit	076001
Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Kodi i Programit	01110

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njesia matëse	Sasia Faktike (2019)	Shpenzimet (2019)	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
					Kosto për Njësi (2019)	Sasia (sipas planit të vitit 2019)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2019)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2019)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit 2019)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit 2019)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit 2019)	Sasia Faktike (në fund të vitit 2019)	Shpenzimet Faktike (2019)	Kosto për Njësi Faktike (në fund të vitit 2019)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
A	Marrje pajisje elektronike dhe shtes	copë	8	1.187	131,85	14	1.500	107	14	1.051	75		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	Realizuar	
B	Shërbim Audio Vizualizimi i Hilet	copë				1	1.500	1.500					#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	pa realizuar	

Treguesit e Performancës/Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njesia Matëse	Sasia e realizuar	Fakti i përcaktimit/progressiv	Komente
A	Produkt			0.0	nuk ka
D	Treguesit e Performancës			0.0	

Drejtori i Ekspert Menaxhues të Programit	Emri	Miranda Gashi	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Ermon HASHARI
	Forma			Forma	
	Data			Data	



ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

ne 000/leke

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (8-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
18AC402	Sistem Audio Prezantim i Blerë	1.500	2019	2019		1.500				Ne proces prokurimi
M760038	Blerje pajisje elektronike dhe zyre	1.500	2019	2019		1.500	1.061	1.061	1.061	Realizuar
		3.000				3.000	1061	1.061	1061	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
1	"Instrumenti Horizontal i Bashkëpunimit"										
	<i>Grant ne natyrë - Kalim Kapital</i>	<i>Grant ne natyrë</i>	38.881,86	2018	2019				38.881,86	38.881,86	realizuar
2	"Transparenca në Sistemin e Shëndetësisë"										
	<i>Grant ne natyrë - Kalim Kapital</i>	<i>Grant ne natyrë</i>	31.176,48	2018	2019				31.176,48	31.176,48	realizuar
			70.058,34					-	70.058,34	70.058,34	

Drejtpuesi i Ekspert Menaxhues të Programit	Emri	Miranda Porja	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgjeni BASHARI
	Firma			Firma	
	Data			Data	